



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:226665

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06502967

**2023:063995**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit E.H., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1616/22 e dt.10.03.2023, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 22.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.Avni Ibrahimimi dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 25.11.2024 përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri E.H., nga i ati B., e ëma F., e gjinisë H., i lindur më ....., në Ferizaj, me vendbanim në fshatin ..... rruga "....." Komuna - Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i shkurorëzuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal ....., i dënuar edhe më parë për vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

1 (6)

Me datë 31.08.2022, rreth orës 03:50h, në fshatin .... K. Ferizaj, saktësisht në restorant “.....”, i pandehuri si pasojë e një mosmarrëveshje lidhur me një borxh që i’a kishte i dëmtuari V. S., me dashje dhe me qëllim të cenimit të integritetit trupor të dëmtuarit duke përdorur forcën i shkakton lëndime trupore, ashtu që deri sa i dëmtuari ishte duke punuar në vendin e tij të punës në restorantin e lartcekur si “kamarier”, dhe ishte duke i shërbyer i pandehuri i e godet në kokë me një mjet “shishe qelqi”, mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore dhe nga kjo goditje të njëjtë i shkakton lëndim të lehtë trupor, siç është e përshkruar në ekspertizën mjeko - ligjore me numër të referencës 040/2023, të datës 03.03.2023, të cilat lëndime rezultojnë të jenë dëmtime të lehta trupore me pasoja – të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4.të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 44, 69, 70 dhe 185 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452, 460 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

## **G J Y K O N**

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind euro), dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo njëzet euro (20 €) do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë euro) për shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore) shumën prej 20 €, /njëzet/ Euro si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, të gjitha shumat obligohet ti paguaj brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari V. H. S. nga fsh..... K Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1616/22 të dt.10.03.2023, ka ngarkuar të pandehurin për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4.të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të pandehurin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 22.11.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seance kane prezantuar prokurori i shtetit, i pandehuri dhe avokati mbrojtës i tij.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehuri për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar, e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4. të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare dhe ate pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, dua të shtoj se me të dëmtuarin pas ndodhjes së këtij rasti kemi kontaktuar dhe jemi marr vesh që në të ardhmen mos të kemi probleme në mes vete dhe kjo ka ndodhur me ndërmjetësim të anëtarëve të familjes, gjegjësisht me babain e të dëmtuarit dhe vet të dëmtuarin për shkak se rasti ka ndodh rastësisht në kafiteri në orët e vonat ku pak a

shumë kam qenë nën ndikim të alkoolit, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprë penale të tillë apo të ngjashme.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë konform nenit 242 të KPRK-së, duke u mbështetur në prova dhe fakte që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj, sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të merr ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë në këtë shqyrtim fillestar ndërsa si rrethanë rënduese të merr parasysht se vepra penale është kryer me mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se, unë si mbrojtësi i të pandehurit e kam këshilluar dhe kemi shqyrtuar rastin që është akuzë e prokurorisë dhe i pandehuri ka vendos që të pranoj fajësinë për veprën penale e cila i ngarkohet duke qenë i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj i propozoj gjyqtarit që të aprovon pranimin e fajësisë duke qenë se plotësohen të gjitha kriteret e parapara me ligj. Me rastin e caktimit të llojit dhe sanksionit penal i propozojmë gjykatës që si rrethana lehtësuese të merren në konsiderim pranimi i fajësisë, pendimi i thellë për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimi i përgjithshëm me gjykatën edhe në këtë fazë, rrethanat familjare si dhe fakti se menjëherë pas ngjarjes kritike i ka kërkuar falje të dëmtuarit i cili e ka pranuar faljen dhe i premtton sigurisht gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprë të tillë apo të ngjashme dhe në veçanti e theksoj edhe rrethanën se ngjarja në kohën kur ka ndodh dhe me të dëmtuarin ka qenë e rastit dhe ka qenë nën ndikim të alkoolit, rrethana këto që sigurisht që gjykata i merr në konsideratë. Mbrojtja konsideron se me një dënim të zbutur në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin e tij mbrojtës, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti i Oficerit i datës

31.08.2022, Raporti mjekësor të lëshuar nga Qendra Emergjente Ferizaj i datës 31.08.2022, me numër të protokollit 967, Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit, të dhënë në polici me datën 10.10.2022, Deklarata e të pandehurit të dhënë në polici me datën 15.09.2022, Ekspertiza mjekoligjore, me numër të referencës 040/2023, e datës 03.03.2023, Fotografitë, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4.të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit veprën të tillë apo të ngjashme, ndërsa rastin konkret si rrethanë rënduese gjeti se i pandehuri më parë ka qenë i dënuar me aktgjykimin 2021:030463 të dt. 05.12.2022, me dënim me kusht, 2022:033490 të dt. 14.11 2022 me dënim me gjobë, dhe PKR 2021:145906 të dt. 22.05.2023, me dënim me gjobë, e që kjo u vërtetua nga Evidenca e gjykatës mbi dënimet penale për të pandehurin dhe përveç këtyre rrethanave gjykata vlerësoj edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me

rrethana te kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen ( preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 460 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe të procedurës, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 4 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,  
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL  
2023:063995, datë 25.11.2024**

**Zyrtare ligjore**  
Kimete Bytyqi

**Gjyqtari i vetëm gjykes:**  
Imri Sejda

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.